

HAPI / STEP / KORAK



# BARAZIA

## - Ligjet dhe realiteti në Kosovë

Prishtinë, 2013



Koalicioni për Barazi HAPI  
Coalition for Equality STEP  
Koalicija za ravnopravnost KORAK



Ky projekt është realizuar me përkrahje të Komisionit Evropian.



**YUCOM**  
Lawyers' Committee for Human Rights



HAPI / STEP / KORAK

# BARAZIA

## - Ligjet dhe realiteti në Kosovë

---

Koalicioni për Barazi HAPI  
Coalition for Equality STEP  
Koalicija za ravnopravnost KORAK

---



Botuesi:



Lawyers' Committee for Human Rights  
Svetogorska 17, 11000 Beograd  
Tel: 011/3344 235  
Fax: 011/3344 425  
E-mail: office@yucom.org.rs  
Web site: www.yucom.org.rs



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë  
Eqrem Çabej 7A, Pristina, 10000, Kosovo  
Tel: +381 (0)38 243 488  
Fax: +381 (0)38 243 490  
E-mail: office@hlc-kosovo.org  
Web-site: www.hlc-kosovo.org

Për botuesin:  
Milan Antonijević

Autorët:  
Betim Zllanoga  
Teuta Hoxha  
Ivana Stjelja

Dizajni, thyerja dhe përgatitja për shtypje:  
BENUSSI design

Shtypshkronja:  
Dosije studio

Tirazhi 250

ISBN 978-86-83209-48-4

---

Botimi është realizuar si pjesë e projektit Rrjetëzimi i organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të njeriut, me përkrahjen financiare të Komisionit Evropian, në partneritet me:



Beogradski centar za ljudska prava



Gej Strejt Alijansa Gay Straight Alliance



---

Deklarata e kufizimit të përgjegjësishë:



Opinionet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



## **DISKRIMINIMI**

- korniza ligjore dhe institucionale	6
Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ndalimi i diskriminimit	7
Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]	7
Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]	8
Struktura institucionale për komunitetet në Kosovë	9
Ligji Kundër Diskriminimit - implementimi dhe mekanizmat	10
Rastet e diskriminimit pranë gjykatave	12
Segregacioni në arsim në Komunën e Gjakovës	12
Rastet nga Gjykata Komunale e Pejës	14
Rastet e Gjykatës Kushtetuese	14
Cemailj Kurtishi kundër Kuvendit Komunal Prizren [18 mars 2010 - Gjykata Kushtetuese]	14
Arjeta Halimi kundër Komunës së Vitisë [30 shtator 2011 - Gjykata Kushtetuese]	15
Rasti i Diana Kastratiti (Gjykata Kushtetuese - Aktgjykimi i dhënë me 26 Shkurt 2013)	16

## **SITUATA E TË DREJTAVE TË KOMUNITETIT LGBT NË KOSOVË**

Situata e komunitetit LGBT - korniza ligjore	19
--	----

## **PJESËMARRJA E GRUAS NË POLITIKË / GRATË NË VENDIM-MARRJE**

Pjesëmarrja e grave në jetën politike - korniza ligjore	23
Pjesëmarrja e grave në jetën politike - praktika shtetërore	23

# DISKRIMINIMI

- korniza ligjore dhe institucionale

## KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE NDALIMI I DISKRIMINIMIT

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me 15 Qershor të vitit 2008, vendos në qendër të saj lirinë, demokracinë dhe paqen në preambulë me theks të veçantë respektimin e drejtave të njeriut dhe lirinë për të gjithë qytetarët brenda kufijve shtetëror (Neni 1.2).

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore konsiderohen si të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë përcaktuar si “bazë e rendit juridik të Republikës” (neni 21), të mbrojtur nga shteti dhe duhet të respektohen nga të gjithë.

Diskriminimi është i ndaluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe garanton barazinë duke respektuar parimet e të drejtave të njeriut. Diskriminimi është i ndaluar në nenin 24 të Kushtetutës, që përcakton barazinë para ligjit. Duke deklaruar se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, opinionit politik apo opinionit tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë.

Masat e tilla do të zbatohen derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë.

Kushtetuta përmban një listë të detajuar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (nenet 23-52), të cilat përcaktojnë rregullat për interpretimin e tyre, mbrojtjen gjyqësore dhe kufizimet (nenet 53-56).

Neni 22 i Kushtetutës parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, para së gjithash Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>1</sup> dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj (ECHR)<sup>2</sup>.

### **Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]**

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

1 Shih <http://www.un.org/en/documents/udhr/>

2 Shih <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/005.htm>



3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
6. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
8. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore,
9. Jonjerëzore dhe Poshtëruese

Është me rëndësi të përmendet kapitulli 3 i Kushtetutës i cili mbron të drejtat e komunitetit dhe pjesëtarëve të tyre. Neni 59 përcakton si më poshtë:

### **Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]**

Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:

1. të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
2. të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre;
3. të marrin arsimim publik para fillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
4. të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
5. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
6. të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente;
7. të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
8. të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë;

9. të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse;
10. të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediat transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
11. të krijojnë dhe të përdorin mediat e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediat elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë Republikën e Kosovës;
12. të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
13. të gëzojnë kontakte të papenguara me dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;
14. të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.

## STRUKTURA INSTITUCIONALE PËR KOMUNITETET NË KOSOVË

Strukturat institucionale për komunitetet ekzistojnë dhe veprojnë në Kosovë. Ekziston Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Shanset e Barabarta dhe çështjet gjinore (ZQM). ZQM ka punuar që nga viti 2002 në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Roli i ZQM është shqyrtimi i legjislacionit, i politikave, procedurave dhe praktikave në pajtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe praktikave të qeverisjes së mirë. Krahas kësaj, ZQM bënë rekomandimet tek Kryeministri dhe Ministritë. Zyra për çështje të Komuniteteve tash është organi kyç koordinues për çështje të komunitetit. Zyra për çështje të Komunitetit është krijuar në vitin 2008 me objektiv të koordinimit të përpjekjeve qeveritare dhe të atyre të donatorëve në punën e tyre me komunitetet, të monitorimit të legjislacionit lidhur me komunitetin dhe për avokimin për respektimin nga ana e qeverisë, të çështjeve të një rëndësie kyçe.

Po ashtu ekziston edhe Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), e cila është themeluar në vitin 2005 me një rregullore të UNMIK-ut<sup>3</sup>. MKK mbron dhe promovon komunitetet dhe pjesëtarët e tyre. Në mandatin e saj përfshihet zhvillimi i politikave, promovimi dhe implementimi i legjislacionit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre (duke përfshirë këtu të drejtën për t'u kthyer), nxitja e krijimit të kushteve të favorshme për kthim si dhe sigurimi i një qasjeje e cila bazohet në të drejtat e njeriut, zhvillimi dhe mbikëqyrja e implementimit të një strategjie të qeverisë lidhur me komunitetet dhe kthimin si dhe mbështetja e zhvillimit dhe e implementimit të strategjive të tilla në të gjitha komunat.

Në vitin 2007 brenda secilës Ministri, është krijuar Njësia Ministrore për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ). Detyra e tyre kryesore është të monitorojë përputhshmërinë ose respektimin e politikave të Ministrisë, legjislacionin dhe aktivitetet me standarde relevante të të drejtave të njeriut. Në po të njëjtin vit (2007), Kryeministri i Kosovës ka krijuar pozitën e Koordinatorit për të Drejtat e Njeriut të Qeverisë së Kosovës (KDNJ). Detyra kryesore e Koordinatorit është të koordinojë punën e Njësive për të Drejtat e Njeriut (NJDNJ) në Ministrinë e Qeverisë së Kosovës me qëllim të kultivimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe të koordinojë aktivitete lidhur me mekanizmat e qeverisë së Kosovës për të drejtat e njeriut.

Presidenti i Kosovës po ashtu ka krijuar Këshillin Konsultativ për Komunitetet (KKK). KKK shërben si një mekanizëm vital për lehtësimin e pjesëmarrjes politike të komuniteteve në nivelin qendror. Me fjalë të tjera, KKK shërben si një urë midis komuniteteve dhe institucioneve qeveritare. Ai ndihmon në krijimin e legjislacioneve dhe politikave të ndryshme të miratuara nga qeveria.

Ekziston, natyrisht, zyra e Avokatit të Popullit. Ajo është themeluar në vitin 2000 dhe është pjesë e Kornizës Kushtetuese.

## LIGJI KUNDËR DISKRIMINIMIT - IMPLEMENTIMI DHE MEKANIZMAT

Kosova ishte një nga vendet e para në regjion që ka miratuar Ligjin Kundër Diskriminimit, qysh në fillim të vitit 2004. Megjithatë, që nga kjo kohë përparimi në zbatimin aktual të dispozitave të tilla progresive ka qenë shumë i ngadaltë dhe vetë ligji ka kontribuar për këtë mungesë të zbatimit për shkak të jo saktësisë. Pasi që Ligji Kundër Diskriminimit aktualisht është duke lënë një zbrazëti në zgjidhjen e rasteve diskriminuese sa i përket procedurave dhe mungesës së një organi zyrtar, ai nuk i plotëson kërkesat për të siguruar një mjet efektiv për viktimat e mundshme, duke paraqitur një rast të arsyetuar në praktikë ose në ligj.

Neni 3 i Ligjit Kundër Diskriminimit përcakton llojet e diskriminimit: (a) Diskriminimi i drejtpërdrejt; (b) Diskriminimi i tërthortë; (c) Ngacmimi; (d) Udhëzim për të diskriminuar; (e) Viktimizimi; dhe (f) Segregacioni.

Fushat e zbatimit të Ligjit Kundër Diskriminimit janë të parapara me nenin 4 të Ligjit. Ky ligj duhet të zbatohet në situatat si më poshtë: (a) kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe profesion, përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, çfarëdo degë të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, duke përfshirë promovimin; (b) qasje në të gjitha llojet dhe të gjitha nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimit, duke përfshirë edhe përvojën e punës praktike; (c) punësimin dhe kushtet e punës, përfshirë shkarkimin nga puna dhe pagesën; (d) anëtarësimi dhe përfshirja në një organizatë të punëtorëve ose të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë anëtarët e së cilës kanë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga organizatat e tilla; (e) mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe shëndetësor, (f) përparësitë sociale, duke përfshirë por jo kufizuar në ndihmën humanitare; (g) arsimin; (h) qasje në strehim dhe për të gjitha format e tjera të pronës (të luajtshme dhe të paluajtshme); (i) qasje në furnizim të mallrave dhe shërbimeve të cilat janë në dispozicion të publikut; (j) trajtimi i drejtë para gjykatave dhe të gjitha organeve tjera që administrojnë drejtësinë; (k) sigurinë personale; (l) pjesëmarrja në çështjet publike, përfshirë të drejtën për të votuar dhe për t'u votuar, (m) qasje në vende publike; dhe (n) çdo të drejtë tjetër të paraparë me ligjet në fuqi.

Siç mund të vërehet neni 4 i Ligjit Kundër Diskriminimit ndalon llojet e ndryshme të diskriminimit në sferën publike dhe private, si dhe shtrirja implementuese është mjaft e gjerë. Megjithatë, dispozitat e hollësishme të kapitullit I të këtij ligji, të cilat përcaktojnë sjelljen e ndaluar, janë prekur kryesisht nga paqartësitë që ekzistojnë në Kapitullin II dhe III në lidhje me procedurat, sanksionet dhe organet për promovimin e trajtimit të barabartë. Si rezultat i kësaj zbatimi është penguar në masë të madhe, pasi që komponentët kryesorë për të siguruar zbatimin e tillë si Qendra për Trajtim të Barabartë, nuk janë themeluar; dhe viktimat e diskriminimit janë ballafaquar me një sistem të komplikuar që nuk është në gjendje të sigurojë mjete efektive<sup>4</sup>.

Në Kosovë ekzistojnë një numër i organeve mandati i të cilave është promovimi i drejtave të njeriut apo barazisë, struktura e tyre ndonjëherë mund të jetë konfuze. Për shkak të status quo-s të këtyre mekanizmave, në vitin 2011 është sugjeruar që këto mekanizma duhet të riorganizohen, mandati i tyre të qartësohet, dhe gjithë struktura institucionale në fushën e drejtave të njeriut të thjeshtëzohet<sup>5</sup>.

4 Raporti i YIHR Kosovo "Ligji kundër diskriminimit", Dhjetor 2012, fq.8

5 European Commission Progress Report on Kosovo, Brussels, 12/10/2012

Mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi në Kosovë janë këto: Qendra për Trajtim të Barabartë<sup>6</sup> (jo funksionale); Avokati i Popullit (Funksional por nuk ka mandat të ndërhyj në sektorin privat); Zyra për Barazi Gjinore (e zëvendësuar në Agjencinë për Barazi Gjinore); Zyrtarë për çështje gjinore në Ministri dhe Komuna; Grupi ndër-ministror; Avokati për Barazi Gjinore (nuk është krijuar ende); Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit; Zyra për Qeverisje të Mirë, Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabartë dhe çështjet Gjinore; Njësit për të Drejtat e Njeriut në Ministri; Njësit për të Drejtat e Njeriut nëpër komuna.

Në përfundim, mekanizmat aktual që veprojnë në Kosovë krijojnë burokraci të panevojshme, e cila e pengon seriozisht efektivitetin e tyre dhe ka ndikim të thellë në grupet më të margjinalizuara që janë duke u ballafaquar me diskriminim të vazhdueshëm, duke përfshirë këtu gratë, pakicat etnike dhe komunitetin LGBT<sup>7</sup>.

Nga shqyrtimi i mekanizmave të ndryshëm, gjithashtu shihet qartë se është bërë një zhvendosje nga organet kuazi-gjyqësore në drejtim të atyre të natyrës promovuese dhe këshillëdhënëse, me një përqendrim veçanërisht të lartë të atyre që veprojnë kryesisht në kuadër të sektorit publik. Meqë diskriminimi ndodhë si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe Ligji Kundër Diskriminimit kërkon që të veprohet në të dytë, miratimi i një qasjeje të tillë të përqendrimin në vetëm një sektor shihet si veçanërisht problematike. Si rrjedhojë, meqë këto çështje janë identifikuar gjerësisht nga raportet ndërkombëtare dhe vendore, është e rëndësishme që të ndërmerren hapa konkretë për të miratuar ndryshime në këtë fushë, si një çështje urgjente! Qëllim kryesor duhet të jenë organet e pavarura që janë të qasshme dhe u shërbejnë atyre individëve që kanë më së shumti nevojë për ndihmë<sup>8</sup>.

## RASTET E DISKRIMINIMIT PRANË GJYKATAVE

### Segregacioni në arsim në Komunën e Gjakovës<sup>9</sup>

Gjatë vitit 2011 dhe 2012, ECMI Kosova<sup>10</sup> ka avokuar kundër edukimit në klasë të ndara të nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në sistemin arsimor të Kosovës. Të mërkurën më 16 janar 2013, kjo ka rezultuar me një padi të dorëzuar në emër të 8 (tetë) prindërve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët ishin të vendosur, nga shkolla fillore "MUSTAFA BAKIJA" në Gjakovë, në një klasë të ndarë të klasës së parë të veçuar nga moshatarët e tyre shqiptarë.

6 Article 9 (5) of the Anti-Discrimination Law

7 YIHR Kosovo report "Anti-Discrimination Law", December 2012 - conclusions

8 ibid

9 Buletini informues ECMI Kosova, Janar 2013

10 www.ecmikosovo.org, INFORMATION BULLETIN – 25 JANUARY 2013, Pristina

Në vitin shkollor 2011-2012, ECMI Kosova ka pranuar raporte mbi ekzistencën e klasave të ndara në tri shkolla në komuna të ndryshme në Kosovë, duke përfshirë edhe shkollën fillore "Mustafa Bakija" në Gjakovë. Kjo praktikë diskriminuese është shprehimisht e ndaluar nga legjislacioni i Kosovës, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rrjedhimisht, ECMI Kosova në bashkëpunim me CLARD-in, ka paraqitur ankesa tek shkollat përkatëse, duke rezultuar, deri në fund të vitit shkollor, në shpërbërjen e të gjitha klasave të ndara dhe shpërndarjen e fëmijëve të veçuar në klasa shumetnike. Në Gjakovë, kjo shpërbërje është shoqëruar me një urdhëresë të lëshuar nga Kryetari i Komunës kundër segregacionit në arsim.

Megjithatë, ECMI Kosova besonte se për një zgjidhje të qëndrueshme të këtij problemi ishte e nevojshme që të krijohet një politikë formale për të parandaluar dhe ndaluar segregacionin në arsim, në përputhje me Strategjinë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës. Për më tepër, ECMI Kosova ka kërkuar bashkëpunim nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në lidhje me këtë çështje, por MASHT-i ishte i mendimit se çështja tashmë ishte rregulluar siç duhet dhe ishte zgjidhur në mënyrë efektive.

Në fillim të vitit shkollor 2012 - 2013, ECMI Kosova ka marrë raporte nga prindërit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që shkolla fillore "Mustafa Bakija" kishte vendosur një klasë të parë vetëm me nxënës që u takojnë komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Prindërit autorizuan ECMI Kosovën dhe CLARD-in për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar ndalimin e kësaj praktike diskriminuese. Një ankesë zyrtare i është paraqitur menjëherë MASHT-it, për të cilën ende nuk është marrë përgjigje, dhe është organizuar një vizitë në shkollë për të verifikuar praktikën e segregacionit.

Fakti që shkolla fillore "Mustafa Bakija" përsëri ka iniciuar politikën e saj të ndarjes së nxënësve në klasë të veçanta, pavarësisht se çështja e segregacionit tashmë ishte ngritur në vitin e kaluar shkollor, ka lënë ECMI Kosovën të besojë se nevojitet një veprim i fortë për të ardhur tek një zgjidhje e qëndrueshme sa i përket këtij problemi. Prandaj, ECMI Kosova në bashkëpunim me CLARD-in, vendosi të mbështesë 8 (tetë) prindërit e fëmijëve të prekur romë, ashkali dhe egjiptianë në paraqitjen e një padie kundër Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjakovës. Kjo padi ishte paraqitur në Gjykatën Themelore në Gjakovë të mërkurën më 16 janar 2013 nga përfaqësuesit ligjor të prindërve duke kërkuar: shpërbërjen e kësaj klase të veçuar, transferimin apo shpërndarjen e nxënësve të prekur në klasë shumetnike; dhe kompensimin për dëmet jo-materiale të shkaktuara për shkak të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Të mërkurën, më 24 Prill të vitit 2013 në ora 10:30, në Gjykatë Themelore në Gjakovë është mbajtur seanca e parë e shqyrtimit përgatitor në lidhje me këtë rast. Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH

Kosovë) dhe Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut janë duke e monitoruar rastin.

### **Rastet nga Gjykata Komunale e Pejës<sup>11</sup>**

Miradie Gashi kundër Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural [7 korrik 2010 – Gjykata Supreme]. Zonja në fjalë shtri ankesë për mbrojtje kundër veprimeve diskriminuese kundër saj mbi bazën e gjinisë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Pas shterjes së procedurave administrative, ankuesja duke u mbështetur në nenin 7 (3) të Ligjit Kundër Diskriminimit bëri një ankesë bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative.

Gjykata Supreme shpalli se është kompetencë e gjykatës së shkallës së parë për rastet e konflikteve administrative. Megjithatë, në këtë rast Gjykata Supreme shpalli se nuk është kompetente për tu marrë me këtë rast dhe identifikoi Gjykatën Komunale në Pejë kompetente për këtë çështje.

Për më tepër, është kompetencë e gjykatës, në territorin e të cilës ka ndodhur veprimi. Ky është një rast i rëndësisë së veçantë për disa arsye: Së pari, ka të bëjë me nenin 7 (3) të Ligjit Kundër Diskriminimit dhe konflikteve administrative, i cili nuk është plotësisht i qartë dhe ishte shumë e rëndësishme të marrim interpretimin e gjykatës në këtë pikë; Së dyti, nuk është plotësisht e qartë se si Gjykata Supreme mund ta shpallë veten si gjykatë e shkallës së parë brenda rasteve të konflikteve administrative pa ndonjë kualifikim dhe akoma të alokojë rastin një gjykate tjetër. Dhe së fundmi, zbatimi i ligjit është mjaft shqetësues, pasi që mund të rezultojë me vendim të gabuar. Kjo për arsye se Ligji për Konfliktet Administrative është miratuar më 16 shtator 2010 dhe ka hyrë në fuqi më 4 nëntor 2010, por gjykata disa muaj më vonë zbaton ligjin e vjetër për konfliktet administrative nga koha e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

## **RASTET E GJYKATËS KUSHTETUESE**

### **Cemailj Kurtishi kundër Kuvendit Komunal Prizren [18 mars 2010 – Gjykata Kushtetuese]<sup>12</sup>**

Z. Kurtishi u ankua se stema e Komunës së Prizrenit reflekton vetëm një komunitet, atë të shqiptarëve që jetojnë në Prizren dhe injoron komunitetet tjera jo-shumicë. Si rezultat stema nuk transmeton mesazhin e multi-etnicitetit që është në zonën e Prizrenit. Prandaj, neni 7 i Statutit të Komunës, që specifikon elementet e stemës, z. Kurtishi pretendon se shkel një numër parimesh Kushtetuese.

11 Raport i YIHR Kosovë - Ligji kunder diskriminimit ne Kosovë: 7 vite pas, Dhjetor 2011

12 Raport i YIHR Kosovë - Ligji kunder diskriminimit ne Kosovë: 7 vite pas, Dhjetor 2011

Gjykata Kushtetuese, së pari shpalli se rasti është i pranueshëm dhe gjeti se ka pasur shkelje të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Prizren që të ruhet, mirëmbahet dhe promovohet identiteti i tyre. Gjykata vendosi se neni 7 i Statutit të Komunës nuk është në përputhshmëri me

Kushtetutën e Republikës së Kosovës, veçanërisht nenet 3, 7 (1), 58 dhe 59. Prandaj, Gjykata urdhëroi Komunën e Prizrenit të ndryshojë statutin dhe stemën e saj.

Raste tjera para Gjykatës Kushtetuese ku referohet ndalimi i diskriminimit përfshijnë Rastin KI 06/10 Valon Bislimi dhe Rasti KO 119/10 Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës. Megjithatë, referenca për ndalimin e diskriminimit është bërë vetëm lidhur me rendin Kushtetues në Kosovë të vendosur mbi këtë parim, ndër të tjera. Asnjëri nga rastet nuk ofron argumente thelbësore specifikisht lidhur me diskriminimin.

Ngjashëm, në rastin e lartpërmendur të z. Kurtishi, kishte komponent të fortë për t'u argumentuar lidhur me diskriminim mbi bazën që komunitetet jo shumicë ishin de facto të diskriminuara nga shumica në Komunën e Prizrenit. Prapë, argumentet të tilla thelbësore nuk janë ngritur nga ana e ankuesit dhe si rezultat Gjykata Kushtetuese nuk ka vendosur në këtë çështje të rëndësishme.

### **Arjeta Halimi kundër Komunës së Vitisë [30 shtator 2011 – Gjykata Kushtetuese]<sup>13</sup>**

Ankuesja kërkoi një vlerësim të kushtetutshmërisë së mos-ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan lidhur me statusin e nxënësit të rregullt në Gjimnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti. Përveç kësaj, ankuesja pretendoi se janë shkelur nenet e Kushtetutës: neni 24, 38 dhe 47.

Ankuesja gjithashtu argumentoi që nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë shkelur: neni 2 i Protokollit 1, neni 9 në bashkëveprim me nenin 14. Gjykata e shpalli këtë rast të papranueshëm pasi që ankuesja nuk i kishte shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe se të gjitha faktet e prezantuara nuk dëshmonin shkeljen e të drejtave kushtetuese. Pastaj Gjykata interpretoi raste nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), posaçërisht rastin e Lejla Sahin 355 dhe aplikon parimet dhe rastet gjyqësore relevante për rastin aktual, që më herët ishte shpallur i papranueshëm, duke përshtuar se një shteti sekular i justifikohet të ndalojë shaminë në objektet shkollore.

Edhe një herë nga ky rast ngritën çështje fundamentale. Së pari, ky është edhe një rast ku ka diskriminim de jure dhe de facto, por prapë argumentet thelbësore nuk janë bërë në këtë pikë. Së dyti, Gjykata Kushtetuese ka gabuar në qasjen që ka aplikuar në këtë rast. Kjo për shkak se

13 Raport i YIHR Kosovë - Ligji kundër diskriminimit në Kosovë: 7 vite pas, Dhjetor 2011



duke shpallur rastin të papranueshëm dhe se ankuesi nuk dëshmoi shkeljen, ata megjithatë nuk

aplikuan efektivisht jurisprudencën nga GjEDNJ për ligjshmërinë e shamsisë në shkolla publike.

### **Rasti i Diana Kastratiti**

#### **(Gjykata Kushtetuese - Aktgjykimi i dhënë me 26 Shkurt 2013)<sup>14</sup>**

Më 18 Maj 2011, është raportuar se Diana Kastrati banore e Prishtinës është vrarë nga bashkëshorti pas refuzimit të kërkesës së saj për mbrojtje emergjente nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Prindërit e Diana Kastratit e kanë dërguar rastin në Gjykatën Kushtetuese, duke akuzuar Gjykatën Komunale të Prishtinës për mosveprim siç parashihet me Kushtetutë dhe ligjet tjera të cilat obligojnë caktimin e mbrojtjes emergjente nga ana e Gjykatës për mbrojtjen e të drejtave individuale.

Me datën 26 shkurt, 2013 Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli vendimin lidhur me rastin e Diana Kastratit, rast që u iniciua nga kampanja në emër të prindërve të Diana Kastratit. Gjykata mori vendim se Gjykata Komunale e Prishtinës ka shkelur të drejtën për jetë të znj. Kastrati, e cila u vra përderisa ishte në pritje që gjykata të përmbush detyrimet dhe ti përgjigjet kërkesës së saj për të lëshuar urdhrin mbrojtës për viktimat e dhunës në familje ashtu siç parashihet me ligj. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dështimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës për të vepruar në një mënyrë të duhur për të mbrojtur zonjën Kastrati ka shkelur të drejtën për jetë dhe të drejtën për mjete juridike, nën Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

---

14 [http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk\\_ki\\_41\\_12\\_mm\\_ang.pdf](http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjkk_ki_41_12_mm_ang.pdf)



SITUATA E TË  
DREJTAVE TË  
KOMUNITETIT LGBT  
NË KOSOVË

## SITUATA E KOMUNITETIT LGBT – KORNIZA LIGJORE

Diskriminimi në bazë të orientimit seksual është ndaluar me Ligjin Kundër Diskriminimit të vitit 2004, Ligji Nr.2004 / 3 (neni 2.a). Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës Neni 24.2 përcakton qartë dinjitetin e barabartë të njerëzve, barazinë e tyre para ligjit, si dhe ndalon çdo lloj diskriminimi përfshirë atë në bazë të orientimit seksual.

Megjithatë, Kushtetuta e Kosovës nuk rregullon as nuk e ndalon martesën mes partnerëve me gjini të njëjtë, por zakonisht ajo është e rregulluar nga një pjesë specifike të legjislacionit, siç është e rregulluar në praktikat moderne në mbarë botën. Neni 37 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk e përkufizon martesën si një bashkim mes një grua dhe burrë, por thekson se një martesë mund të jetë bashkimi në mes dy personave të rritur me pëlqimin e tyre reciprok.

Gjithashtu është e rëndësishme të përmendet se neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e definon shtetin e Kosovës si një laik, që do të thotë se vetëm ligjet që rrjedhin nga Kushtetuta dhe janë bërë nga Kosova janë të vlefshme. Çdo pretendim tjetër se politikat fetare janë mbi ligjin, janë shkelje të rendit kushtetues dhe të drejtave themelore të njeriut.

Në Kosovë personat me orientim të ndryshëm seksual mund haptazi të kryejnë shërbimin civil dhe ushtarak, pra nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë.

Deklarimi i bashkëjetesës apo partneritetit ligjor midis partnerëve të të njëjtit seks nuk është e rregulluar ende me ndonjë udhëzim administrativ të legjislacionit, kështu që ata mbeten të panjohur për tani, njëjtë si adoptimi i fëmijëve nga çiftet homoseksuale.

Ndryshimi i seksit nuk është i rregulluar ose i ndaluar me ligjet e Kosovës. Kosova ende nuk i ka qartësuar çështjet e lidhura me identitetin gjinor, identitetin gjinor mbetet liri personale, nuk ka rregullore që sanksionojnë çështjet e dokumenteve ose Gjendjes Civile që kanë të bëjnë me identitetin gjinor të personave.

Njerëzit që i përkasin komunitetit LGBT në pothuajse të gjitha rastet e preferojnë të fshehin identitetin e tyre dhe preferencat seksuale. Ata shmangin të flasin haptazi për këtë temë dhe në lidhje me të drejtat e tyre. Ata kanë frikë në të qenit të diskriminuar dhe stigmatizuar si dhe nga pasojat.<sup>15</sup>

Homofobia është ende e rrënjosur thellë në shoqërinë kosovare: anëtarët e komunitetit LGBT janë viktimat të diskriminimit të gjerë jo

---

15 Konferenca “Të drejtat e komunitetit LGBT në Kosovë”, organizuar me rastin e datës 17 Maj - Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe transfobisë (IDAHO), Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Qendrën për Emancipim Shoqëror (CSE), mbështetur nga Ambasada e Finlandës në Prishtinë.

vetëm në sferën publike, por edhe dhe sidomos në familjet e tyre, të dënuar të mbeten të padukshëm.<sup>16</sup>

Sulmi ndaj publikimit të revistës së Kosovo 2.0, numrit që shtjellonte seksualitetin, më 14 dhjetor 2013 është shembulli më i mirë i ekzistimit të homofobisë në Kosovë. Një grup prej rreth njëzet burra brutalisht hynë në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë “Boro e Ramizi”, një vend në qendër të Prishtinës, ku të rinjtë takohen dhe ku mbahen ngjarjet kulturore. Sulmi përfundoi me shkatërrimin e podiumit dhe të agresionit fizik ndaj një anëtari të ri, ndërkohë që zyrtarët e zbatimit të ligjit, përgjegjës për të garantuar sigurinë, kanë qëndruar pa lëvizur.

Një analizë e asaj çfarë ndodhi mund të gjendet në një komunikatë në Facebook lëshuar nga Kosovo 2.0 në ditën pas: “ngjarjet e dhunshme të pakontestueshme natën e fundit tregojnë nevojën e të menduarit të lirë dhe kritik (në vend). Gjithashtu tregojnë se sa lehtë të drejtat e njeriut mund të vihen në rrezik nga ekstremizmi fetar, nga bandat e tifozëve të futbollit dhe nga menje-ngushtësia.”<sup>17</sup>

Ajo çfarë i ndodhi Kosovo 2.0 nuk është rasti i parë i dhunës ndaj për-krahësve dhe komunitetit LGBT në Kosovë. Në fund të vitit 2011 stafi i një bar që ishin deklaruar si “gay-friendly” ( “Pure Pure”) ka marrë kërcënime të rënda në internet dhe personalisht nga një grup i mbështetësve të futbollit në kryeqytet.

---

16 ibid

17 <http://www.kosovotwopointzero.com/en/magazine/kosovo-2.0-issue-4-sex-22-02-2013>



PJESËMARRJA E  
GRUAS NË  
POLITIKË / GRATË  
NË VENDIMARRJE

## PJESËMARRJA E GRAVE NË JETËN POLITIKE - KORNIZA LIGJORE

**Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas (KEFKG)** është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë, dhe këtë garanton **Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht** nenet 3, 7, 22, 24 dhe 45, **Ligji mbi Barazinë Gjinore**<sup>18</sup>;

**Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme** (Sipas nenit 27 kërkohet që në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik, të ketë së paku tridhjetë për qind (30%) meshkuj dhe së paku tridhjetë për qind (30%) femra, me një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, duke numëruar nga kandidati i parë në listë.

**Ligji për zgjedhjet lokale në Kosovë** (Neni 3.1 Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet pa asnjë diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm, neni 7.1 çdo listë e kandidatëve duhet të përbëjë së paku 30% të kandidatëve të certifikuar nga gjinia tjetër, në nenin 8.4 Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë brenda një entiteti politik nuk i janë ndarë së paku 30% të totalit të ulëseve për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i kualifikuar nga gjinia tjetër në listën e rirënditur derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për pakicën gjinore të bëhet të paktën 30%), **dhe Ligji Kundër-diskriminimit** (neni 6.1), janë bazat ligjore që garantojnë të drejtat e grave në shoqërinë kosovare.

### **Pjesëmarrja e grave në jetën politike - praktika shtetërore**

Grupet e grave kanë zhvilluar strategji të avokimit, ose veçmas ose nëpërmjet rrjeteve (Rrjeti i Grave të Kosovës)<sup>19</sup>, duke kërkuar përfaqësim më të mirë të grave në të gjitha nivelet vendim-marrëse. Këto përpjekje kanë rezultuar në ngritjen e kuotës gjinore prej 30% mbi nivelin e përfaqësimit politik dhe publik, por jo domosdoshmërisht në nivelet e larta të vendim-marrjes. Nga 120 deputetë në Parlament 34 janë gra, parlamentarët janë emëruar për të udhëhequr shumicën e komisioneve, ku pjesa më e madhe e punës legjislativë është bërë.

Përfshirja e përgjithshme e grave në jetën politike dhe publike mbetet e ulët, dhe ka një nevojë për të bërë shumë më tepër në mënyrë që të ndryshohet situata. Është e rëndësishme të përmendet se Kosova ka për Presidente një femër, e që është emëruar pas një marrëveshjeje politike ndërmjet partive politike të Kosovës.

18 Ligji nr. 2004/2

19 <http://www.womensnetwork.org/?FaqeID=1>



Përfaqësimi i grave në Qeveri: nga 6 (gjashtë) zëvendëskryeministra, 2 (dy) janë femra, nga 19 ministri, 2 janë femra njëra prej të cilave mban edhe postin e zëvendëskryeministres, dhe (1) një Sekretare të Përgjithshme të Ministrisë.

Në nivel lokal varësisht nga komuna pjesëmarrja e grave është 25% - 31% në kuvendet lokale, nga 37 komuna nuk ka asnjë femër Kryetare kurse ka vetëm një femër zëvendës-kryetare.